PUBLIC
Date original: 08/11/2024 14:35:00
Date translation: 21/08/2026 13:31:00

KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës:	**KSC-BC-2020-04**
	Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës
Vendosi:	**Trupi Gjykues I**
	Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse
	Gjykatës Roland Dekers
	Gjykatës Zhilber Biti, gjykatës raportues
	Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë
Administratore:	Fidelma Donlon
Data:	8 nëntor 2024
Gjuha:	Anglishte
Klasifikimi:	**Publik**

Urdhër për Caktimin e Datës për Shqiptimin e Urdhrit për Zhdëmtim

---

T'u njoftohet:

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz
Maria Raxhiejovska

Mbrojtjes së Pjetër Shalës
Zhan-Lui Zhilisen
Hedi Auini
Leto Kariolu

Administratores
Fidelma Donlon

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest
Filipo de Miniçis
Gaja Pergolo
Eva Viler

PUBLIC
Date original: 08/11/2024 14:35:00
Date translation: 21/08/2026 13:31:00

TRUPI GJYKUES I ("Trupi Gjykues") lëshon këtë urdhër për caktimin e datës për shqiptimin e urdhrit të zhdëmtimit.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 korrik 2024, Trupi Gjykues lëshoi Aktgjykimin për këtë çështje gjyqësore.[1] Në Aktgjykim, Trupi Gjykues bëri me dije se më vonë do të lëshonte urdhrin për zhdëmtim në bazë të neneve 22(8) dhe 44(6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe vendosi të mbante juridiksionin për këtë aspekt.[2]

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

2. Trupi Gjykues vë në dukje nenet 22(3), (7) dhe (8), 43(2) dhe 44(6) të Ligjit dhe rregullat 159(2) dhe 164(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja").

III. ANALIZË

[1] KSC-BC-2020-04, F00847, Trupi Gjykues I, *Aktgjykim dhe Dënim* (Aktgjykimi), 16 korrik 2024, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 24 shtator 2024, F00847/RED.
[2] Aktgjykimi, para. 1042, 1127.

3. Trupi Gjykues rikujton se në bazë të nenit 43(2) të Ligjit, aktgjykimi shpallet nga Trupi Gjykues publikisht.

4. Gjithashtu, Trupi Gjykues rikujton se në bazë të rregullës 159(2) të Rregullores, aktgjykimi, ose një përmbledhje e tij, shqiptohet publikisht në emër të popullit të Kosovës dhe në praninë e të akuzuarit, përveçse kur rrethana të posaçme përligjin mungesën e të akuzuarit.

5. Për më tepër, Trupi Gjykues vëren se, në përputhje me rregullën 164(2) të Rregullores, rregulla 159(2) e Rregullores zbatohet edhe për shqiptimin e dënimit.

6. Duke qenë se Urdhri për Zhdëmtim parashihet nga neni 44 i Ligjit, me titullin "Dënimet", që shqiptohet krahas dënimit me burg, Trupi Gjykues gjykon se dispozitat e lartpërmendura të Ligjit dhe të Rregullores zbatohen edhe për shqiptimin e Urdhrit për Zhdëmtim në bazë të neneve 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.

7. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues ka vendosur, për arsye organizative dhe duke pasur parasysh rrethanat e çështjes gjyqësore, se, në bazë të rregullës 159(2) të Rregullores, është e përshtatshme që ta shqiptojë Urdhrin për Zhdëmtim për këtë çështje gjyqësore **të premten, 29 nëntor 2024, në orën 11:00**, në seancë publike dhe në praninë e z. Pjetër Shala.

PUBLIC
Date original: 08/11/2024 14:35:00
Date translation: 21/08/2026 13:31:00

IV. VENDIM

8. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

a. **CAKTON** datën për shqiptimin e Urdhrit për Zhdëmtim në këtë çështje gjyqësore **të premten, 29 nëntor 2024, ora 11:00**, në seancë publike; dhe

b. **URDHËRON** z. Pjetër Shala të jetë i pranishëm personalisht në sallën e gjyqit në selinë e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia,
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E premte, 8 nëntor 2024
Në Hagë, Holandë.